BULETINI ZYRTAR
I KOMUNËS SË DOLLNENIT

Buletini zyrtar i komunës së Dollnenit del sipas nevojës	**04.06. 2014** **Numër 06, viti 2014** **DOLLNEN**	**xhiro-llog. 300020000212077** **NT 6021067000004** **Tel: 048/453-210**

Në bazë të nenit 36, paragrafi 1, pika 2 nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 5/02) dhe nenit 52, paragrafi 1, pika 7 nga Statuti i komunës së Dollnenit ("Buletini Zyrtar i komunës së Dollnenit``, nr. 08/05, 04/09 dhe 02/10) Prefekti i komunës së Dollnenit e solli këtë:

K O N K L U Z Ë

për korrigjimin e llogarisë përfundimtare për vitin 2013 me nr. 07-888/2 e sjellur nga ana e Këshillit të komunës së Dollnenit më datën 26.05.2014.

2. Konkluza do të shpallet në Buletinin Zyrtar të komunës së Dollnenit .

Nr. 08-933/1 Prefekti
04.06.2014 D-r Boshe Millosheski
Dollnen

Në bazë të nenit 36, paragrafi 1, pika 2 nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 5/02) dhe nenit 52, paragrafi 1, pika 7 nga Statuti i komunës së Dollnenit ("Buletini Zyrtar i komunës së Dollnenit``, nr. 08/05, 04/09 dhe 02/10) Prefekti i komunës së Dollnenit e solli këtë:

K O N K L U Z Ë

për Plan dhe Program për zbatimin e dezinfektimit të planifikuar sistematik të NJVL –Dollnen për vitin 2014

1. Shpallet vendim për Plan dhe Program për zbatimin e dezinfektimit të planifikuar sistematik të NJVL –Dollnen për vitin 2014nr. 07-888/3 e sjellur nga ana e Këshillit të komunës së Dollnenit më datën 26.05.2014.

2. Konkluza do të shpallet në Buletinin Zyrtar të komunës së Dollnenit .

Nr. 08-933/2 Prefekti
04.06.2014 D-r Boshe Millosheski
Dollnen

PROGRAM PËR ZBATIMIN E DEZINSEKTIMIT PREVENTIV TË PLANIFIKUAR NË NJVL – DOLLNENI për vitin 2014

Përpunoi: Zoran Zdraveski
Komuna e Dollnenit-Dollnen
Dr. Boshe Millosheski, prefekt

Kryetar i Këshilit të
Komunës së Dollnenit
Husein Hasanoviq

Në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e banorëve nga sëmundjet infektive "Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 66/24) si dhe ligjet për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për mbrojtje të banorëve nga sëmundjet infektive "Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 139/08, 99/2009 dhe 86/2011) dhe nenit 40 obligativ është dezinsektimi i vendbanimeve gjatë paraqitjes së insekteve ose rreziku nga paraqitja e sëmundjeve, të cilat përhapen me insekte. Për dezinsektimin dhe deratizmin e lagjeve dhe rrethinës së tyre kompetente janë komunat dhe qyteti i Shkupit, të cilat i kryejnë me ndihmën teknike të Qendrave për Shëndet Publik dhe personave tjerë juridik, të cilat i plotësojnë kushtet e parashikuara me këtë ligj dhe rregullave të sjellura në bazë të tij (neni 42).

Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale dhe qyteti i Shkupit janë të detyruar që të kryejnë dezinfektim dhe deratizim preventiv në territorin e tyre, për atë qëllim është e domosdoshme që Prefekti dhe Këshilli i NJVL të sjellin vendim si dhe të sigurojnë mjete financiare për këto procese.

1. HYRJE

Si rezultat i zhvillimeve ekonomike botërore si dhe ndryshimeve klimatike ekziston mundësia për zgjerimin intensiv të vektorëve e me atë edhe numri i personave të sëmurë nga sëmundje infektive, të cilat përhapen nëpërmjet të vektorëve. Vektorë, të cilët përhapin sëmundje infektive tek njerëzit janë nyjorët, gjitarët përfshirë edhe brejtësit. Vektorë nyjorë siç janë mushkonjat dhe këpushat janë organizma gjakftohtë dhe veçanërisht janë të ndjeshëm në ndryshimet klimatike. Ndërmjet sëmundjeve, të cilat përhapen nëpërmjet vektorëve ka edhe të tillë që regjistrohen edhe në Republikën e Maqedonisë siç janë: sëmundja e **Lajmi-it**, **Ethet e Nilit Perëndimor**, **Lajshmanioza, Malaria, Ethet Hemoralgjike** dhe të tjerë, të cilët në të ardhmen paraqesin rezik dhe ka mundësi zëmadhe të regjistrohen në Republikën e Maqedonisë. Për atë është e nevojshme që në mënyrë preventive të ndërmerren masa përkatëse me qëllim të asgjësimit të tyre pasi që bëhet fjalë për sëmundje transmisive (vektor -sëmundje infektive). Hapat tona para se gjitha duet të orientohen kah asgjësimi i vektorëve dhe edukimi i popullatës për mbrojtje personale adekuate, por edhe përforcimin e kapaciteteve shëndetësore për diagnostifikimin me kohë dhe kurimin përkatës. Qendra për Shëndet Publik – Prilep këtë program për asgjësimin e mushkonjave në territorin e komunës së Dollnenit e përgatiti në bazë të ekspertizave përkatëse të bëra në terren gjatë të cilëve janë të ndjekur parametra të domosdoshme për llogaritjen e gjendjes momentale në raport me këtë dëmtues dhe kushtet, të cilat ndihmojnë rritjen, shumimin dhe zhvillimin e tyre.

Dezinsektimi preventiv paraqet masë sistematike, afatgjate e planifikuar, e cila kërkon bashkëpunim intersektorial të më shumë institucioneve dhe ka për qëllim një qëllim të vetëm zvogëlimin e numrit të insekteve dëmtuese deri në pragun e tolerancës biologjike si dhe pengimin e rritjes, zhvillimit dhe shumimit të insekteve, të cilat paraqesin vektorin e një numër të madh të sëmundjeve ngjitëse, të cilat ndikojnë në mënyrë shqetësuese por edhe shkaktojnë reagime alergjike. Dezinsektimi zbatohet me zbatimin e masave mekanike, fizike, biologjike, metodave kimike dhe mjeteve, të cilat ekologjikisht janë të pranueshme dhe në mënyrë, e cila nuk lejon që të vihet në rezik jeta e banorëve dhe kafshëve si dhe insekteve të dobishme.

2. Morfologjia dhe kuptimi shëndetësor i mushkonjave.

Rëndësi më të madhe nga të gjitha insektet kanë mushkonjat dhe ata paraqesin objekt trajtimi gjatë zbatimit të procedurave të dezinsektimit. Mushkonjat janë insekte të vogla këmbëgjate, të ndjeshme me një gjatësi prej 1.6 deri më 12.5 mm. Organi buzor është adoptuar për pickimin dhe thithjen e gjakut. Pickojnë dhe thithin gjakun vetëm femrat, pasi që me gjakun ushqehen dhe u është i nevojshëm për zhvillimin e vezëve, nga e cila më vonë zhvillohet formë adulte e mushkonjës. Mushkonjat femra gjakun e thithin nga kafshë të ndryshme homeoterme dhe heteroterme si dhe nga vetë njeriu. Mushkonjave për zhvillim u është i nevojshëm uji dhe për atë thuhet se deri sa ka sipërfaqe ujore do të ketë edhe mushkonja. Mushkonjat kanë transformim të plotë nga veza-larva-kukulla-adult. Mushkonjat janë të përhapura në mbarë botën dhe janë të regjistruara mbi 3000 lloje të tyre. Në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë gjithsej 51 lloje të mushkonjave , nga të cilat 12 janë lloje vektoriale.. Gjatë hulumtimit të bërë në vitin 2010 në lokalitetet e Republikës së Maqedonisë janë të regjistruara 7 lloje të mushkonjave edhe atë:

Anopheles maculipennis
Ochlerotatushungaricus

Ochlerotatusgeniculatus
Culexmimeticus
Culextritaeniorhynchus
Culex martini
Orthopodomyiapulchripalpis

Nga këto tri janë lloje vektoriale, ndërsa lloji i mushkonjës Aedes albopictus ose e ashtuquajtura "Mushkonjë tigër" nuk është e vërtetuar në Republikën e Maqedonisë. Aktivitet më të madh mushkonjat kanë në muzg, ndërsa varësisht nga lloji i tyre pickojnë edhe gjatë orëve të mbrëmjes. Gjatë ditës pushojnë në fllad në vende më të errëta nga shkaku se janë shumë të ndjeshme ndaj dritës diellore. Dimrin e kalojnë në gjendje hibernimi si femra të fekonduara ose në sipërfaqe ujore si larva ose vezë. Në Republikën e Maqedonisë rëndësi më të madhe kanë mushkonjat e llojit Anopheles Aedes dhe Culex. Anopheles është mushkonja, e cila është vektor e malarjës. Ekzistojnë mbi 100 lloje, në vit zhvillojnë 4-8 gjenerata dhe kanë mundësinë e fluturimit prej 2-3 kilometrave. Për anofelesit karakteristike është se pas pickimit pushon në murre në brendësinë e objekteve. Mushkonjat e llojit Aedes janë të rëndësishme për atë se e përhapin virusin Nili Perëndimor me mushkonja të livadheve të vërshuara ose nga mushkonjat e malit. Fluturojnë mbi 30 kilometra dhe zakonisht zhvillojnë 4-5 gjenerata. Culex mushkonjat janë mjaft agresive dhe gjithashtu quhen edhe mushkonja urbane pasi që femrat vezët i nxjerrin në mjedise urbane. Kanë aftësinë e vogël të fluturimit, jo më shumë se 300 metra dhe për atë shkak veprojnë lokalist përreth çerdheve të tyre. Periudha e tyre e metamorfozës është e shkurtër, rreth 10 ditë kështu që gjatë një muaji mund të zhvillohen tri gjenerata të mushkonjave.

3. **Sëmundje transmetuese infektive dhe karakteristika epidemiologjike**

Virusi nga **Nili Pewrëndimor (WNF)** është arbovirus nga familja Flaviridae. Nga virusi mund të sëmuren njerëzit , shpendët, mushkonjat, kuajt dhe gjitarë tjerë. Virusin e bartin mushkonjat, Burimi i virusit janë shpendët e sëmurë, kuajt e tjerë dhe nëpërmjet të thithjes së gjakut nga kafsha e infektuar dhe me pickimin e njeriut virusi përhapet në nikoqirin e ri. Virusi për herë qëparë është i izoluar në vitin 1937 në regjionin e Ugandës, në derdhjen e lumit Nil Perëndimor dhe deri në vitin 1999 është përhapur nëpër Afrikë, Lindjen e Afërt dhe Azi. Në vitin 2000 epidemi të mëdha janë paraqitur në Rumuni, Itali, Rusi dhe shtete tjera evropiane. Në ditët e sotme Ethet e Nilit Perëndimor janë të regjistruara gati në të gjitha shtete ballkanike e disa raste në mënyrë zyrtare janë të dëshmuara edhe në republikën e Maqedonisë. Fotografia klinike te Ethet e Nilit Perëndimor ndryshon nga forma simptomatike deri tek sëmundjet e vështira neurologjike. Sëmundja mund të zhvillohet në tri forma edhe atë:

-Forma simptomatike – rreth 80 % të infektuarve
- Pasqyrë e lehtë klinike në formë të gripit – rreth 19 % të infektuarve
-Forma neuroinvazive – rreteh 1% të infektuarve.

Pas 2 deri më 14 ditëve nga infektimi zhvillohen simptome identike si të gripit siç është kokë dhembja, plogështi, vjellja, ënjtja e gjëndrave limfatike, ndërsa vetëm në një nga 150 të infektuar mund të zhvillohet formë e rëndë të encefalitisit, meningitisit ose paralizës.

Sëmundja e Lajmit (Lyme Borreliosis)- paraqet sëmundje bakteriale infektive nga lloji i sëmundjeve me vatra-natyrore të sëmundjeve. Sëmundja është e shkaktuar nga Borelia burgdorferi, mikroorganizëm nga klasa e Spiroheti. Agjenci jeton në disa brejtës të vegjël, shpendë dhe shumë shpesh në kaprenj dhe drerë. Në natyrë ndërmjet kafshëve bakteri përhapet nëpërmjet këpushave, ndërsa këpushat e infektuar nëpërmjet pickimit e përhapin agjentin infektiv te njeriu. Sëmundja ka tri stade. Stadium i hershëm i lokalizuar, i cili është karakteristik me efloreshencë në vendin e pickimi e quajtur "syri i demit" shtresë e quajtur erythema migrans, simptome të ngjashme me gripin siç është temperatura, ethet, zmadhimi i gjëndrave limfatike stadium i hershëm i desiminuar (kur borelia desiminohet në organizmin) dhe stadium të vonshëm perzistent me simptome të sistemit kardiovaskular dhe nervor. Në periudhën 2001-2011 gjithsej të paraqitur janë 27 të sëmurë nga **Sëmundja e Lajmit** në Republikë e Maqedonisë.

Lajshminioza (Leishmaniosiscutanea/visceralis)

Shkaktar i **Lajshminiozës** është protoza nga familja Tripanosomidae. I ka më tepër lloje: Leishmania trupica, Leishmania, infantum, të cilat i ka në Republikën e Maqedonisë dhe leishmani major, leishmania aeitiopca dhe tjerë. Depo dhe burimi i sëmundjes mund të jenë njerëzit dhe disa lloje të kafshëve siç janë brejtës të egër, mishngrënësit, qentë shtëpiak dhe nikoqirë të panjohur. Përhapja e sëmundjes bëhet nëpërmjet të pickimit të Flebotomus, kur ai thith gjakun e njeriut. Sipas lokalizimit dallohen dy lloje të sëmundjeve edhe atë Lajshmaniozë visceriale përndryhs e njohur edhe si Karla Azar dhe Lajshmaniozë e njohur si orientale. Lajshmanioza viscerale është sëmundje sistematike, e cila karakterizohet me temperatura të çrregullta, anemi hipohromne, splenomegali e madhe dhe kaheksi. Lishmania e lëkurës fillon me papule, e cila ë filli është pa dhimbje e më tej hapen dhe shëndrohen në ulcerë me dhimbje. Lajshminza si sëmundje është e regjistruar në më shumë se 90 shtete në botë, gjithashtu është e regjistruar edhe në Republikën e Maqedonisë. Për periudhën prej vitit 2001-2011 në Maqedoni janë të regjistruar 76 të sëmurë.

Ethet hemoralgjike kongo-krime-paraqet sëmundje akute virale. Bëhet fjalë për sëmundje me vatër natyrore , e cila përhapet nëpërmjet të këpushave. Depoja e sëmundjes janë pata e egra dhe shpendët, Rruga elementare e përhapjes është transmisivja, ndërsa realizohet nëpërmjet të pickimit nga këpusha (rreth 90 % nga rastet e regjistruar) Mundet edhe nëpërmjet rrugës së kontaktit kur virusi në organizmin e ri hyn nëpërmjet lëndimeve dhe mikro lëndimeve të lëkurës dhe mukozës. Rruga e kontakti mund të realizohet nëpërmjet të lëndëve të kontaminuar të freskëta. Sëmundja karakterizohet me temperaturë të lartë, kokë dhimbje, dhimbje në kyçin dhe ekstremitetet, intoksikacion të përgjithshëm, ekzantem hemoralgjik, hemoralgji në organe të brendshme në lartësi deri më 70 %.

Më shpesh kjo sëmundje paraqitet në vatra endemike në një numër të madhe të shteteve në Azi, Afrikë, Evropë dhe Amerikën Jugore. Në Maqedoni në vitin 2010 është i paraqitur një rast i Etheve hemoralgjike kongo-krime.

Malaria- është sëmundje akute infektive e shkaktuar nga parazit të ashtuquajtur Plasmodium. Malaria është antropozonozë dhe nga ajo sëmuret vetëm njeriu. Depo e vetme dhe burim i sëmundjes është njeriu, i cili mund të jetë burim i sëmundjes gjatë sëmundjes dhe si gametobartës, respektivisht vetëm atëherë kur në qarkullimin e gjakut qarkullojnë gametocite. Malaria është vektor bartës i sëmundjes dhe bartet nëpërmjet të mushkonjave të llojit Anopheles, të cilat i kemi edhe në Republikën e Maqedonisë. Inkubacioni zgjat nga 10 deri në 23 ditë. Pasqyra klinike karakterizohet me kokë dhimbje të fortë e ndjekur me ethe dhe rritje të shpejtë të temperaturës deri më 41° e ndjekur me dhimbje në kurriz dhe nën harkun e djathtë brinjor. Sulmi zgjat 10 orë dhe e ndjek djersitje profuze dhe ligështim i përgjithshëm. Mund të paraqitet edhe verza, manifestime trombotike të kapilareve të vogla jo vetëm në lëkurë por edhe në të gjitha organet vitale. Paroksizmat zgjasin edhe deri në dy javë. Diagnoza bëhet me marrjen e gjakut për pikë të dendur. Malaria është sëmundje endemike në hemisferën jugore, por raste sporadike të importuara të kësaj sëmundje janë të regjistruara edhe në Evropë edhe në Maqedoni. Nga viti 2001 deri në ditët e sotme në Maqedoni janë të regjistruara 9 raste të importuara nga të cilat njëri është me përfundim vdekje.

Q-Ethe- Është zoo antropoozë e shkaktuar nga një lloj rikecesh. Bartet nëpërmjet disa rrugëve bartëse edhe atë: rrugë aerogjene me thithjen e pluhurit të kontaminuar, rrugë e alimentuar nëpërmjet të konsumimit të qumështit të pazier dhe jo të pasterizuar, rrugës kontaktive gjatë punës me kafshë të sëmurë dhe transmisive nëpërmjet të këpushave të infektuara nga kafshë të buta dhe të egra. Pasqyra klinike karakterizohet me ethe, kokë dhimbje, plogështi dhe djersitje e ndjekur me kollitje të thatë, ekspertoracion të përgjakur dhe dhimbje në kafazin e kraharorit. Sëmundja regjistrohet në mbarë botën. Në Maqedoni nga viti 2001-2011 janë të regjistruar 76 të sëmurë.

Denga(Ethe denga hemoralgjike)-Është sëmundje akuto-infektive tropikale e shkaktuar nga viruse. Për depo natyrale të dengës konsiderohen disa lloje të majmunëve. Sëmundja ndërmjet majmunëve përhapet nëpërmjet mushkonjave. Burim i sëmundjes përkrah majmunëve dhe mushkonjave në mjediset urbanë është edhe njeriu i infektuar. Pas infektimit mushkonja mbetet e infektuar për tërë jetën e saj disa mujore.

Njeriu është burimi i sëmundjes një kohë të shkurtër 3-4 ditësh nga faza defibrile. Vektorë të kësaj sëmundje janë mushkonjat të llojit Aedes aeqypti, Aedes bromelise, dhe Aedes africanus. Denga paraqitet në dy forma edhe atë në denga Ethe dhe Denga ethe Hemoralgjie, e cila karakterizohet me trombocitopeni, gjakderdhje dhe shok.Simptomat e dengës janë temperaturë e lartë, plogështi, gërdi, vjellje, bradikardi etj. Çdo vit në botë 50 milion të njerëzve infektohen me denga, ndërsa në 30.000 sëmundja kalon në mënyrë fluturuese Sëmundja denga është endemike në afrikë, Amerikë, Azinë Juglindore, paqësorin Perëndimor dhe në Mediteranin Lindor. Deri tash në Republikën e Maqedonisë nuk ka të paraqitur rast.

Çikungunia (Chikungunya) – Sëmundje**,** e cila përhapet nëpërmjet pickimit para se gjithash nga "mushkonja tigër"- Aedes Albopictus, e cila tash më është endemike në R. E Shqipërisë, Kroaci dhe Greqi, por në përputhje me hulumtimin për praninë e saj në Republikën e Maqedonisë e kryer në vitin 2010 nuk është vërtetuar prania e të njëjtës.
Burimi i sëmundjes është njeriu dhe disa lloje të majmunëve. Paraqet sëmundje virale, e cila karakterizohet me temperaturë të lartë deri më 40°C, plogështi i përgjithshëm, kokë dhembje, gjakderdhje petihiale për gjatë lëkurës, dhimbje në kyçe, të cilat vazhdojnë edhe në disa muaj. Në Republikën e Maqedonisë nuk ka të regjistruar raste.

4. Eliminimi i mushkonjave dhe format e tyre zhvillimore

Eliminimi i planifikuar i mushkonjave paraqet zbatim sistematik i organizuar shumëvjeçar i një varg të masave me qëllim të reduktimit të shpeshtësisë së popullimit e me atë edhe mbatjen e gjendjes stabile epidemiologjike në raport me paraqitjen e vektorit të sëmundjeve ngjitëse. Zbatimi i dezinsektimit paraqet një proces kompleks, i cili nuk nënkupton vetëm përdorimin e substancave kimike për eliminimin e mushkonjave. Eliminimi i mushkonjave realizohet në katër nivele, gjatë së cilës në kontinuitet duhet të kihet kujdes për mbrojtjen e diverzitetit biologjik në një rrethinë të caktuar.



Masat e sanacionit- Kanë për qëllim dhe bazohen në zvogëlimin ose përjashtimin e kushteve për rritje dhe shumimin e mushkonjave. Ajo nënkupton mbushjen e moçaleve dhe vendeve me baltë, sigurimin e derdhjes së ujit, dispozitimi i drejtë i mbeturinave të ngurta, kositja e rregullt e sipërfaqeve të gjelbërta dhe pastrimi i vendeve ku ndalet uji dhe tjera masa higjieno-teknike.

Edukimi shëndetësor i banorëve. Nga ana e Qendrës për Shëndet Publik rregullisht do të informohet popullata për vektor bartësit e sëmundjeve ngjitëse (nëpërmjet të pjesëmarrjes në televizionin lokal, radio, gazeta) përpunimin e fletushkave edukativo-informative, broshurave dhe fllaerëve.
Komunikimi i drejtpërdrejtë me popullatën në terren është i rëndësishëm me qëllim të ngritjes së nivelit të mundësisë individuale të popullatës për vetëmbrojtje dhe largimin e çerdheve të mushkonjave.

Masat biologjike për eliminimin e mushkonjave- Rezultate efikase arrihen (atje ku është mundshme) me shfrytëzimin e predatorëve të larvave të mushkonjave siç është peshku i vogël Gambusia Holbrooki, i cili më shpesh ndodhet nëpër liqene, ku ai e mbron mjedisin jetësor dhe shumëllojshmërinë biologjike. Përdorimi i prodhimeve biocide siç është Bacilusthurigiensisvar is raelensis në gjendje të lëngët, pluhurit ose granulateve.

Masa kimike për eliminim.

A) Zbatimi i rregullatorëve për rritje, të cilat i ka në forma të granulateve përdoren për ujëra të pastra dhe nuk janë të dëmshme për llojet tjera të kafshëve.

B) Insekticide kundër larvave , të cilat kanë për qëllim që ta prishin stadin zhvillimor të mushkonjës, që do të thotë se ndikojnë në formën e larvës, gjatë së cilës pengohet zhvillimi i plotë i mushkonjave adulte. Ekzistojnë insekticide për larvat në gjendje të lëngët, granulate, pluhur e në lidhje me aplikacionin mund të përdoren me stërpikës ose të hedhen me dorë në sipërfaqet ujore. Insekticidet për larva kanë efekt të jashtëzakonisht të lartë, aplikimi është shumë më i lehtë dhe nuk e prishin biodiversitetin. Që të mund të përdoret insekticide i caktuar për larva e nevojshme është që për të njëjtin të merret leje nga Ministria e Shëndetësisë.

C) Dezinsektimi adulticid- Mund të përdoret si stërpikje reziduale në objekte të mbyllura ose si mjegullim ftohtë/ngrohtë nga dheu gjatë trajtimit të të sipërfaqeve më të mëdha. Paraqet në aksion të ndërlikuar, i cili ka për qëllim eliminimin e formave adulte të mushkonjës dhe dezinfektim, i cili kërkon vëmendje të lartë në raport me dozën preparatin si dhe mbrojtjen personale të realizueseve dhe banorëve. Ka efekt më të vogël nga insekticidet për larvat. Insekticidi detyrimisht duhet të ketë leje për përdorim nga Ministria e Shëndetësisë.

5. Dinamika dhe mënyra e zbatimit të aktiviteteve

Që të arrihet efekt të rëndësishëm gjatë zbatimit të dezinsektimit e nevojshme është ndjekje e përhershme të gjendjes në teren gjatë së cilës duhet të merren parasysh të gjitha karakteristikat biologjike, hidrometeorologjike dhe ekologjike atje ku zbatohen trajtimet. E nevojshme është që në territorin e komunës së Dollnenit të zbatohen dy lloje të trajtimit edhe atë:

Dezinfektim për larva- Do të realizohet nga muaji prill deri në muajin shtator sipas dinamikës paraprakisht të caktuar varësisht nga shkalla e përhapjes së mushkonjave. Vlerësimet dhe këqyrjen do ta kryej shërbimi pranë Qendrës për Shëndet Publik.

Teknika e zbatimit: Hedhje me dorë në vende ku ka ujëra të ndejshme.

Sipërfaqe për trajtim: Do të trajtohen sipërfaqe dhe vende ku ka ujëra të ndaluar dhe sipërfaqeve, të cilat do të jenë objekt i marrëveshjes në pajtim me konstruksionin financiar dhe planit aktual operativ i aprovuar ndërmjet vetëqeverisjes lokale dhe realizuesit të dezinsektimit.

Dezinsektimi adut: Do të realizohet në disa raste në muajt maj, qershor, korrik dhe gusht.

Dinamika e trajtimit: Sipas planit aktual operativ.

Mjet për dezinfektim adult: Do të përdoret insekticid Aqua Q-othrinesc 25me substancë aktive deltamethrin 20gr/lit.

Teknika e realizimit. Trajtimet realizohen me mjet ULV për mjegullim të ftohtë.

Sipërfaqe për trajtim- Sipërfaqe e kontraktuar sipas procedurës me tenderime.

Qendra për Shëndet Publik si realizues i procedurave lëshon lajmërim në formë të shkruar deri te:

Inspektorati Shtetëror Sanitar për kohën, mënyrën dhe preparatin për realizimin e dezinsektimit preventiv.

Mjetet për informim disa ditë para fillimit tëprocedurës me qëlli tëinformimit të banorëve për vendin dhe kohën e trajtimit.

Shoqatës së Bletarëve me qëllim marrjes sëmasave të domosdoshme pr mbrojtjen e bletëve.

Lëshon raport deri te organi mbikëqyrës për aktivitetet e realizuara.

Lëshon vërtetim sanitar për DDD shërbim

Në kontinuitet e ndjek gjendjen me infestimin me mushkonja në territorin e komunës së Dollnenit.

Kryetar i Këshillit të
Komunës së Dollnenit
Husein Hasanoviq

Në bazë të nenit 36, paragrafi 1, pika 2 nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 5/02) dhe nenit 52, paragrafi 1, pika 7 nga Statuti i komunës së Dollnenit ("Buletini Zyrtar i komunës së Dollnenit``, nr. 08/05, 04/09 dhe 02/10) Prefekti i komunës së Dollnenit e solli këtë:

K O N K L U Z Ë

për themelimin e subjektit juridik Shkollë e mesme komunale në v.b. Zhitoshe

1. Shpallet vendim për **themelimin e subjektit juridik Shkollë e mesme komunale në v.b. Zhitoshe** me nr. 07-888/3 e sjellur nga ana e Këshillit të komunës së Dollnenit më datën 26.05.2014.
2. Konkluza do të shpallet në Buletinin Zyrtar të komunës së Dollnenit .

Nr. 08-933/3 Prefekti
04.06.2014 D-r Boshe Millosheski
Dollnen

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, pika 8 nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 5/02) dhe nenit 16, paragrafi 1, pika 8 dhe neni 28, paragrafi 11 nga Statuti i komunës së Dollnenit ("Buletini Zyrtar i komunës së Dollnenit``, nr. 08/05) dhe nenit 10, paragrafit 2 nga Ligji për Arsim të Mesëm Këshilli i komunës së Dollnenit më datë 26.05..2014 e solli këtë:

V E N D I M

Për themelimin e subjektit juridik Shkollë e Mesme Komunale-gjimnaz, f. Zhitoshe – komuna e Dollnenit.

Neni 1

Këshilli i komunës së Dollnenit në bazë të mendimit për themelimin e shkollës së mesme komunale nga ana e Qeverisë së Maqedonisë me nr. 42-3060/1 nga 23.04.2014 themelon subjekt juridik Shkollë e Mesme Komunale-gjimnaz, f. Zhitoshe, në të cilën do të zhvillohet mësim në gjuhën shqipe dhe maqedonase me kërkesë-elaborat paraprakisht të përgatitur për themelimin e shkollës së mesme.

Neni 2

Anulohet vendim paraprak i sjellur nga ana e Këshillit të komunës së Dollnenit për themelimin e subjektit juridik Shkollë e Mesme Komunale – gjimnaz, f. Zhitoshe – komuna e Dollnenit me nr. 07-530/5 nga 17.03.2014 dhe numër 07-747/7 nga 30.04.2014

Neni 3

Shkolla e Mesme Komunale-gjimnaz, f. Zhitoshe do ta mbajë emrin "Prerodba" në gjuhën shqipe "Rilindja"(kuptimi i emrit është shprehur edhe në gjuhën shqipe pasi që mësimi do të zhvillohet në gjuhën shqipe dhe maqedonase) respektivisht emri i shkollës do të jetë "Shkollë e Mesme Komunale-gjimnaz, "Prerodba", f. Zhitoshe –komuna e Dollnenit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi nga dita e sjelljes së tij.

Kryetar i Këshilit të
Komunës së Dollnenit
Husein Hasanoviq

Në bazë të nenit 36, paragrafi 1, pika 2 nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 5/02) dhe nenit 52, paragrafi 1, pika 7 nga Statuti i komunës së Dollnenit ("Buletini Zyrtar i komunës së Dollnenit``, nr. 08/05, 04/09 dhe 02/10) Prefekti i komunës së Dollnenit e solli këtë:

K O N K L U Z Ë

për përfshirjen e objekti të ndërtuar jo legal jashtë përfshirjes ndërtimore në v.b. Llazhan

1. Shpallet vendim për **përfshirjen e objekti të ndërtuar jo legal jashtë përfshirjes ndërtimore në v.b. Llazhan** me nr. 07-888/5 e sjellur nga ana e Këshillit të komunës së Dollnenit më datën 26.05.2014.
2. Konkluza do të shpallet në Buletinin Zyrtar të komunës së Dollnenit .

Nr. 08-933/4 Prefekti
04.06.2014 D-r Boshe Millosheski
Dollnen

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, pika 8 nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 5/02) dhe nenit 16, paragrafi 1, pika 8 dhe neni 28, paragrafi 11 nga Statuti i komunës së Dollnenit ("Buletini Zyrtar i komunës së Dollnenit``, nr. 08/05) dhe nenit 10, paragrafit 2 nga Ligji për Arsim të Mesëm Këshilli i komunës së Dollnenit më datë 26.05..2014 e solli këtë:

V E N D I M

për përfshirjen e objekti të ndërtuar jo legal jashtë përfshirjes ndërtimore në v.b. Llazhan

Neni 1

Ky vendim do të paraqesë plotësim në Programin Vjetor për përpunimin e planit urbanistik të planifikuar të komunës së Dollnenit për v.b. Llazhan për vitin 2014.

Neni 2

Vetëqeverisje Lokale e komunës së Dollnenit gjatë përpunimit të ardhshëm të planit urbanistik të planifikuar të komunës së Dollnenit për v.b. Llazhan për vitin 2014 obligohet të bëj zgjerimin e përfshirjes së planifikuar n. V.b. Llazhan me qëllim përfshirjen e objekti të ndërtuar jo legal me qëllim G4 (Depo)

Objekti jo legal është i ndërtuar në afërsi të rrugës regjionale R 23335 nëPK me nr. 1009 për KK Llazhan, e cila shtënë pronësi tëpersonit Ismail Asanoski nga v.b. Llazhan.

Neni 3

Ky vendim do të jetë pjesë përbërëse e Programit Vjetor për përpunimin e planit urbanistik të planifikuar të komunës së Dollnenit për v.b. Llazhan për vitin 2014 dhe programet e ardhshme vjetore për planifikim urbanistik deri te realizimi i plotë i procedurës për përfshirjen e objektit jo legal nga neni 2 i këtij vendimi në bazë të Ligjit për të Vepruar me objekte të ndërtuar jo legale.

Neni 4

Ky vendim sillet në bazë të mendimit me nr. 09-5345/2 nga 17.07.2013 lëshuar nga Ndërmarrja Publike për rrugë Shtetërore e Republikës së Maqedonisë.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e shpalljes së tij në Buletinin zyrtar të komunës së Dollnenit.

Kryetar i Këshilit të
Komunës së Dollnenit
Husein Hasanoviq